



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të

UNI – Universum International College

dhe

Sindikatës së Policisë së Kosovës

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit ndërmjet UNI – Universum International College (në vijim: “UNI”), përfaqësuar nga Valon Murati, Zv. President për Marrëdhënie me Jashtë dhe Bashkëpunim me Komunitetin dhe Sindikatës së Policisë së Kosovës (në vijim: “SPK”), përfaqësuar nga z. Avdi Hoti, Kryetar, është vendosja e bashkëpunimit për ofrimin e zbritjeve në tarifat e shkollimit për anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe fëmijët e tyre, si dhe organizimi i trajnimeve profesionale me fokus në Inteligjencën Artificiale dhe fusha të tjera të interesit për anëtarët e SPK-së.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit dhe zotimet

1. UNI zotohet të ofrojë zbritje në tarifat e shkollimit për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës që janë anëtarë të SPK-së, si dhe për fëmijët e tyre.
2. Kjo zbritje do të aplikohet për të gjitha programet e studimit të ofruara nga UNI. Në varësi të programit zbritjet janë të ndryshme.

3. Për përfitimin e zbritjeve, pjesëtarët e Policisë së Kosovës duhet të dëshmojnë anëtarësinë në SPK përmes një vërtetimi të lëshuar nga ky institucion dhe të paraqesin dokument identifikues policor. Fëmijët e tyre duhet të paraqesin një kopje të certifikatës së lindjes dhe kopjen e dëshmisë së anëtarësisë së prindit në SPK.

4. UNI zotohet të organizojë trajnime profesionale për anëtarët e SPK-së, me fokus në fushën e Inteligjencës Artificiale, si dhe në tematika të tjera të nevojshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale të pjesëtarëve të policisë.

5. Palët zotohen të mbajnë kontakte të rregullta për koordinimin e aktiviteteve, shkëmbimin e informacioneve dhe zbatimin e suksesshëm të këtij Memorandumi.

6. UNI angazhohet që të gjithë përfituesit e këtyre lehtësirave të trajtohen me respekt, korrektësi dhe barazi gjatë procesit të regjistrimit dhe marrjes së shërbimeve në kolegji.

Neni 3

Pikat e Kontaktit

1. Me qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi, palët caktojnë këto pika kontakti:

1.1. Për Sindikatën e Policisë së Kosovës – Zyra e Kryetarit të Sindikatës

1.2. Për UNI-në - Zyra për Marrëdhënie me Jashtë dhe Bashkëpunim Institucional

Neni 4

Ndryshimi dhe ndërprerja e memorandumit

Ndryshimi, plotësimi ose ndërprerja e këtij Memorandumi, bëhet vetëm me marrëveshje të dyanshme me njoftim paraprak prej 30 ditësh nga pala kërkuuese.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, palët do të formojnë një grup punues për zgjidhjen e saj. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet, secila palë ka të drejtë të tërhiqet nga Memorandumi, duke njoftuar me shkrim 60 ditë përpara.

Neni 6


Kopjet e Memorandumi

Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë nënshkruese.


Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi më 02.08.2025 dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohore, përderisa palët pajtohen për vazhdimin e bashkëpunimit.


Valon Murati
Zv. President për Marrëdhënie me Jashtë




Avdi Hoti
Kyetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës

